




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE



VENDIM

Nr. 710, datë 12.10.2016

PËR

MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR KËRKESAT DHE KRITERET PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË SË OPERATORIT TURISTIK”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 51, të ligjit nr.93/2015, “Për turizmin”, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullores “Për kërkesat dhe kriteret për ushtrimin e veprimtarisë së operatorit turistik”, sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ngarkohen Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes dhe Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

Në mungesë dhe me porosi

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

NIKO PELESHI

MINISTRI I ZHVILLIMIT EKONOMIK,
TURIZMIT, TREGTISË DHE SIPËRMARRJES

MILVA EKONOMI

RREGULLORE

“PËR KËRKESAT DHE KRITERET PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË SË OPERATORIT TURISTIK”

Neni 1 Objekti

Në këtë rregullore përcaktohen kërkesat dhe kriteret të cilave u nënshtronen të gjithë personat fizikë a juridikë, sipërmarrjet që ushtrojnë veprimtarinë nëpërmjet platformave elektronike që licencohen për ushtrimin e veprimtarisë, si operator turistik, në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 2 Kërkesat dhe kriteret për ushtrimin e veprimtarisë si operator turistik

Personi fizik ose juridik, që ushtron veprimtarinë, si operator turistik, duhet të zbatojë kërkesat e mëposhtme:

1. Ambienti i ushtrimit të veprimtarisë nuk mund të jetë më pak se 16 m^2 dhe duhet të jetë i pajisur me pajisje të përshtatshme pune, përfshirë tavolinën e punës, karrige, pajisje informatike, dhe të ketë akses në internet, akses në rrjetin telefonik etj.
2. Nëse në mjedisin e punës punojnë më shumë se dy punonjës, sipërfaqja minimale e detyrueshme duhet të jetë të paktën 4 m^2 mbi sipërfaqjen minimale të përcaktuar në pikën 1, të këtij nenit, për çdo punonjës shtesë.
3. Në rastin kur subjekti e ushtron veprimtarinë në më shumë se një mjedis pune, në secilin prej tyre duhet të përbushë kriteret e parashikuara për operatorin turistik.
4. Nëse subjekti ofron shërbime në mënyrë të drejtpërdrejtë te klientët fundorë, duhet që:
 - a) në një vend të dukshëm, në pjesën e jashtme të mjedisit të punës, ku ushtron veprimtarinë, të vendosë një tabelë me emrin e subjektit dhe adresën e tij;
 - b) në hyrje të mjedisit të punës, ku ushtron veprimtarinë, të vendosë një tabelë me orarin e punës;

- c) në një vend të dukshëm në brendësi të mjedisit të punës, ku ushtron veprimtarinë, të vendosë licencën e miratuar nga struktura përgjegjëse;
 - ç) në një vend të dukshëm të afishojë dhe të informojë klientin në lidhje me kushtet, përbajtjen dhe çmimin për çdo shërbim individual;
 - d) të sigurojë një mënyrë të përshtatshme për depozitim e ankesave nga klientët, duke përfshirë, por pa u kufizuar, një libër ankesash në mjedisin e punës, adresë elektronike për pritjen e ankesave etj. Dhe, brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës, të japë një përgjigje me shkrim;
 - dh) në përfundim të afatit 3-ditor për shqyrtimin e ankesës nga operatori turistik, parashikuar në shkronjën “d”, të pikës 4, të këtij nenit, klienti mund të paraqesë ankesë pranë Inspektoratit Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut, në përputhje me nenin 17, të ligjit nr.93/2015, “Për turizmin”, dhe rregulloren për trajtimin dhe shqyrtimin e anksesave.
5. Për shërbimin që ndërmjetëson, operatori turistik siguron nënshkrimin e një kontrate midis klientit, ofruesh të shërbimit që ushtron aktivitetin sipas legjislacionit në fuqi dhe/ose operatorit turistik, konratë e cila ruhet nga palët nënshkruese dhe duhet të dokumentojojë organizimin e shërbimit.
6. Çdo paketë udhëtimi, e përgatitur nga operatori turistik, kur shitet te klienti fundor nga operatori turistik, në mënyrë të drejtpërdrejtë në mjedisin e punës ose nëpërmjet komunikimit elektronik, shoqërohet me kontratën e lidhur mes klientit dhe operatorit turistik, sipas legjislacionit në fuqi, e nënshkruar nga palët në formën e printuar ose sipas parashikimeve të ligjit nr.9880, datë 25.2.2008, “Për nënshkrimin elektronik”.
7. Kontrata e paketës së udhëtimit shoqërohet gjithmonë me kontratën e sigurimit që mbulon përgjegjësinë e operatorit turistik ndaj palëve të treta për dëmet e shkaktuara si rezultat i mospërmbushjes së detyrimeve, përfshirë rastet e paaftësisë paguese dhe falimentimit.
8. Operatori turistik detyrohet të garantojë klientin se, në rast falimentimi, pas lidhjes së kontratës, do të rimbursojë plotësisht vlerën e paguar nga ana e klientit.

Në rast falimentimi të operatorit turistik gjatë zbatimit të kontratës, ky i fundit detyrohet që, përpos rimbursimit të vlerës monetare, të rikthejë klientin në pikën e nisjes.

9. Operatori turistik është i detyruar që, përgjatë organizimit të një pakete udhëtimi dhe ekskursioni, për më shumë se 10 persona, duhet të angazhojë gjatë tij të paktën një shoqërues udhëtimi dhe përgjatë vizitave në vende të vizitueshme, një udhërrëfyes turistik të certifikuar sipas legjislacionit në fuqi.
10. Operatori turistik mbron të dhënat personale të administruara prej tij në përputhje me ligjin nr.9887, datë 10.3.2008, "Për mbrojtjen e të dhënavë personale", përfshirë identitetin, adresën, vendin, kohën e udhëtimit, qëndrimin dhe çmimin, dhe nuk i përhap të dhënat te palë të treta, pa pëlqimin paraprak të shprehur të klientit, me përjashtim të rasteve kur detyrohet nga ligji ta japë këtë informacion tek organet përkatëse shtetërore.

Neni 3 **Përfaqësimi i operatorit turistik**

1. Operatori turistik përfaqësohet gjatë ushtrimit të veprimtarisë nga përfaqësuesi ligjor (administratori) dhe drejtuesi teknik.
2. Një operator turistik, për të ushtruar veprimtarinë e tij, duhet të punësojë një drejtues teknik.
3. Drejtuesi teknik nuk mund të punojë në më shumë se një operator turistik, në cilësinë e drejtuesit teknik.
4. Drejtuesi teknik, për nevoja të ushtrimit të veprimtarisë së tij, duhet të vërtetojë se:
 - a) zotëron një gjuhë të huaj, nëpërmjet një dëshmie, certifikate, diplome ose një dokumenti të ngjashëm me to, lëshuar nga subjekti i certifikuar nga ministria përgjegjëse për arsimin për organizimin e testimeve ndërkombëtare, në nivelin B2, ose nga institucioni i arsimit të lartë publik ose privat, që është miratuar nga ministria përgjegjëse për arsimin për të ofruar programe të akredituara të gjuhëve të huaja, me vlerësim mbi/edhe notën 7 (shtatë);

- b) zotëron një gjuhë të huaj të dytë, nëpërmjet një dëshmie, certifikate, diplome ose një dokumenti të ngjashëm me to, lëshuar nga subjekti i certifikuar nga ministria përgjegjëse për arsimin për organizimin e testimeve ndërkontrollare, në nivelin B1, ose nga institucioni i arsimit të lartë publik ose privat, që është miratuar nga ministria përgjegjëse për arsimin për të ofruar programe të akredituara të gjuhëve të huaja, me vlerësim mbi/edhe notën 6 (gjashtë).
5. Përfaqësuesi ligjor dhe drejtuesi teknik, në çdo rast, janë përgjegjës për zbatimin e dispozitave të kësaj rregulloreje.